



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 2 / 3 Prot

Vlorë, më 09 . 01 . 2023.

**VENDIM**

**Nr. 16 , datë 28.12.2022**

**PËR**

**PËR SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES ME NR.7 PROT.,  
DATË 29.08.2017, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.12, DATË 04.08.2017, "PËR  
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZUAR, TË  
SHOQËRISË "STS DEVELOPMENT" SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

**V E N D O S I:**

1. Saktësimin e koordinatave të vendndodhjes së burimit ujor (burimi i bambullit) të lejes me Nr. 7 Prot., datë 29.08.2017, miratuar me vendimin Nr.12, datë 04.08.2017 nga Këshilli i Basenit Vjosë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së burimit ujor (burimi i bambullit) do të saktësohen si më poshtë:  
Nga: X= 444790; Y= 443945; Z= 700 m.m.n.d në X= 4439850; Y= 4447950; Z= 700 m.m.n.d.  
(Gauss Kruger) X= 524910.33; Y= 4447619.66; Z= 700 m.m.n.d. (KRGJSH)

2. Miratimin e rinovimit të lejes me koordinatat e vendndodhjes së burimit ujor (burimi i Bambullit) të saktësuar si më sipër, për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazuar (kur përdorimi është për >151 shishe/orë, > 1 l/sek) me Nr.7 prot., datë 29.08.2017, miratuar nga KBU Vjosë me Vendimin Nr.12, datë 04.08.2017, të shoqërisë "STS DEVELOPMENT" sh.p.k., me vendndodhje: Pranë burimit të Bambullit, Njësia Administrative Zagori, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë.

3. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujqor: Burimi i Bambullit

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Kompleksi i depozitimeve brekçiet shpatore të vendosura mbi formacionet flishore të oligocenit të poshtëm Pg3 1 .

Koordinatat e vendndodhjes së burimit (KRGJSH)

X= 524910.33; Y= 4447619.66; Z= 700 m.m.n.d.

Qmes-vje= 20 l/sek

Qeko= 15 l/sek

Sasia e ujit që jepet për përdorim: Q = 5 l/sek

4.Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

5.Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.



**K R Y E T A R**

**FLAMUR MAMAJ**